# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6026
E martë, 2 qershor 2020
çmimi 0.40 €


## Fillon puna në ambulancat specialistike

FAQE 6





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KA FILLUAR ZBATIMI I FAZËS SË TRETË TË LEHTËSIMIT TË MASAVE NDAJ COVID-19 FAQE 3

# KOSOVA FILLON T'I KTHEHET NORMALITETIT

Republika e Kosovës ka nisur fazën e tretë të masave lehtësuese ndaj Covid-19. Në këtë fazë, pas 80 ditësh, janë rihapur kufijtë tokësorë, janë hapur kafenetë, baret, restorantet, qendrat tregtare dhe çerdhet për fëmijë. Hapja e tyre është bërë me rekomandim të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKShPK). Lehtësimi i masave ka bërë që qytetarët të vërshojnë në sheshe, kafene dhe dyqane. Në Prishtinë është vërejtur fluks më i madh i qytetarëve, ndërsa pas hapjes së kufijve qytetarë të shumtë ia kanë mësyrë Shqipërisë nëpërmjet pikës kufitare në Morinë



# TË MËRKURËN PRITET TË VOTOHET QEVERIA E UDHËHEQUR NGA HOTI



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka dorëzuar në Kuvend nënshkrimet për thirrjen e seancës në të cilën pritet të votohet qeveria e re e drejtuar nga Avdullah Hoti. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka bërë me dije se në marrëveshje edhe me partnerët e koalicionit (AAK-në, Nismën dhe minoritetet) kanë kërkuar thirrjen e seancës së Kuvendit për të mërkurën në orën 11:00. Ai është shprehur i bindur se LDK-ja i ka votat për formimin e qeverisë së re. Ndërkaq presidenti i vendit, Hashim Thaçi, në një konferencë për media ka thënë se rrethanat aktuale në vend kërkojnë një qeveri funksionale dhe efektive. "Pres që sa më parë të themelohet qeveria e re. Kosova nuk e ka luksin të këtë vakuum në qeverisje", ka deklaruar Thaçi FAQE 4-5

## AKTUALE



**KOLAJ: KOMUNA E GJAKOVËS E KA MENAXHUAR MIRË SITUATËN ME PANDEMINË COVID-19** F. 10

**BËHET THIRRJE PËR GARANTIMIN E TË DREJTAVE TË BARABARTA PËR TË GJITHË FËMIJËT NË KOSOVË** F. 7

**KRYETARËT E KOMUNAVE ANKOHEN PËR MOSINFORMIM ME KOHË NGA QEVERIA PËR HAPJEN E ÇERDHEVE** F. 5

## EKONOMI



**RIFILLOJNË PUNËN KAFITERITË, KËRKOHET NDIHMA E INSTITUCIONEVE PËR TA PARANDALUAR BANKROTIMIN E TYRE** F. 8

**BQK-JA: ENDE NUK ËSHTË MARRË VENDIM PËR SHTYRJE TË MËTUTJESHME TË KËSTEVE TË KREDIVE** F. 8

## SPORT

**SEJDIU: NDAJ PRISHTINËS DUAM REZULTAT POZITIV** F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Ambasadori austriak nis detyrën në Tiranë, Meta kërkon përfundimin e reformës zgjedhore

Tiranë, 1 qershor - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur të hënën ambasadorin e Austrisë, Christian Steiner, me rastin e paraqitjes së letrave kredenciale. Presidenti Meta i ka uruar Steinerit suksese në misionin e tij në Shqipëri, në dobi të forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të shkëlqyera ndërmjet dy vendeve dhe popujve tanë.

Presidenti Meta e ka falënderuar për mbështetjen që Austria vazhdon t'i japë procesit të integrimit evropian të Shqipërisë. Në këtë kontekst, Meta ka theksuar rëndësinë që ka angazhimi konstruktiv i çdo aktori institucional në detyrimet që ka për zbatimin e 15 prioriteteve të BE-së që kushtëzojnë procesin e negociatave të anëtarësimit, përfshirë përfundimin sa më parë të reformës zgjedhore në Këshillin Politik dhe miratimin e saj në Parlament sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it.

"Realizimi me konsensus i reformës zgjedhore, si dhe progresi i besueshëm në të 15 prioritetet e BE-së, do të ndihmonin edhe Austrinë të kishte argumente më shumë në favor të Shqipërisë në kuadrin e debatit në BE", u shpreh presidenti Meta. Ai e ka falënderuar veçanërisht ambasadorin Steiner edhe për ndihmat dhe asistencën e ofruar nga autoritetet austriake pas tërmetit tragjik që goditi vendin tonë nëntorin e kaluar, si dhe ato për përballimin e pandemisë Covid-19.

Presidenti Meta shprehu kënaqësinë për trendin pozitiv në shkëmbimet ekonomike e tregtare dypalëshe, vlerësoi asistencën austriake në edukimin profesional, si dhe



kërkoi që përvoja e shkëlqyer e shkollës së mesme profesionale të Shkodrës të shtrihet edhe më gjerë në vendin Shqipëri.

# Rama: Për reformën zgjedhore e bëmë pjesën tonë



Tiranë, 1 qershor - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se për reformën zgjedhore mazhoranca e ka bërë pjesën e vet për arritjen e konsensusit më 31 maj. "Sa për reformën zgjedhore dhe dizinformimet që vazhdojnë, do të presim edhe sot pa folur pasi kemi bërë pjesën tonë duke respektuar afatin 31 maj. Sot kemi angazhuar edhe ushtrinë për operacionin e pastrimit të inerteve nga sheshet e rindërtimit, ku shpejt do të nisin projektet", ka thënë Rama.

Ka pasur edhe një përgjigje për opozitën që e ka akuzuar se ka shkuar për fundjavë në Paris me charter personal. "Unë s'jam në Francë, por në Shqipëri qysh pardje! Kam shkuar pasditen e të premtes e jam kthyer mesditën e të shtunës për një vizitë informale të nivelit të lartë dhe 'shpenzimet e luksit e të fundjavave jashtë' ua kam lënë atyre që të vetmen punë kanë të më shajnë ditë-natë! Pikë", ka thënë Rama.

# Arrin në 140 numri i të vdekurve në Maqedoni nga Covid-19

Shkup, 1 qershor - Maqedonia e Veriut ka regjistruar shtatë persona të vdekur dhe 89 të infektuar me koronavirus në 24 orët e fundit. Kjo është shifra më e lartë e raportuar nga mesi i muajit prill, kur në këtë vend ishte konsideruar piku i sëmundjes Covid-19 që shkakton ky virus. Sipas raportit të Ministrisë së Shëndetësisë, viktimat janë: nga dy në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë si dhe një tjetër në Strugë.

Marrë parasysh shifrat e fundit, numri i personave që kanë humbur jetën nga koronavirusi në territorin maqedonas ka arritur në 140.

Sa iu përket të infektuarve, numri më i madh është regjistruar në Shkup, që vazhdon të mbetet vatër e infektimit. Nga 727 motrat e testuara, në Shkup pozitivë kanë rezultuar 35 persona. Zona me rrezik të lartë paraqiten edhe qytetet e Shtipit me 27 të infektuar, Kumanova me 12 të infektuar dhe Tetova me 7 raste. Qytetet e tjera janë kryesisht me nga një të infektuar.

Komisioni i Sëmundjeve Infektive ka diskutuar për mundësinë e shtrëngimit të masave pas të dhënave për rritjen e numrit të të infektuarve.

Ministria e Administratës Publike ka njoftuar se për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve, nga puna ka liruar personat e moshuar si dhe të sëmurët kronikë.

Në vetizolim janë futur zëvendëskryeministrja Milla Carevski, ministri i Administratës, Damjan Mançevski dhe disa zyrtarë tjerë të Lidhjes Social-Demokrate (LSDM) të cilët kishin kontakte me





nënkryetarin e kësaj partie, Muhamed Zeqiri.

Ky i fundit është infektuar me koronavirus.

Që nga fillimi i pandemisë në Maqedoninë e Veriut me koronavirus janë regjistruar 2 315 persona. Prej këtyre, 1 569 janë shëruar ndërsa 606 mbeten aktivë.

## Pezullohet kontrata për dezinfektimin e mauneve në pikat kufitare që kushtonte 22 euro

Prishtinë, 1 qershor (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme Administratës Publike (MPBAP) ka bërë me dije se ka pezulluar kontratën për pagesën e tarifës prej 22 eurove për dezinfektim të mauneve që hyjnë në Republikën e Kosovës. Kjo ministri ka thënë se me këtë kontratë parashihej dezinfektimi i kampioneve që hyjnë në Kosovë, duke përfshirë edhe ata nga Shqipëria. "Pezullohet kontrata për dezinfektimin e mauneve që vijnë në Republikën e Kosovës. Dezinfektimi i kamionëve parashihej në kuadër të masave për luftimin e pandemisë së Covid-19. Nga ky moment importuesit nuk kanë nevojë t'i dezinfektojnë maunet në pikat kufitare", ka njoftuar MPBAP-ja.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ka filluar zbatimi i fazës së tretë të lehtësimit të masave ndaj Covid-19

# Kosova fillon t'i kthehet normalitetit




**Republika e Kosovës ka nisur fazën e tretë të masave lehtësuese ndaj Covid-19. Në këtë fazë, pas 80 ditësh, janë rihapur kufijtë tokësorë, janë hapur kafenetë, baret, restorantet, qendrat tregtare dhe çerdhet për fëmijë. Hapja e tyre është bërë me rekomandim të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKShPK). Lehtësimi i masave ka bërë që qytetarët të vërshojnë në sheshe, kafene dhe dyqane. Në Prishtinë është vërejtur fluks më i madh i qytetarëve, ndërsa pas hapjes së kufijve qytetarë të shumtë ia kanë mësyrë Shqipërisë nëpërmjet pikës kufitare në Morinë**

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Republika e Kosovës ka filluar t'i kthehet normalitetit pas aplikimit të masave kufizuese ndaj Covid-10 për 80 ditë rresht. Nga e hëna Kosova ka filluar zbatimin e fazës së tretë të lehtësimit të masave në të cilën lejohet ushtrimi i shumicës së aktiviteteve që ishin ndaluar në pjesën e parë të muajit mars për ta frenuar përhapjen e koronavirusit.

Me rekomandim të IKShPK-së dhe ministrive të linjës, janë hapur kufijtë tokësorë në gjashtë pika kufitare, janë hapur kafenetë, baret, restorantet dhe qendrat tregtare.

Gjithashtu, janë rikthyer nëpër institucione publike të gjitha veprimet dhe i gjithë stafi, edhe barnatoret e licencuara i janë rikthyer punës dhe orarit të rregullt.

Lehtësimi i masave ka bërë që qytetarët të vërshojnë në sheshe, kafene dhe dyqane.

Në Prishtinë është vërejtur një fluks më i madh i qytetarëve pas lehtësimit të masave, pavarësisht prej thirrjeve të institucioneve politike dhe profesionale për kujdes dhe aplikim të distancës sociale.

## Rihapen kufijtë tokësorë

Rihapjen e kufijve tokësorë në Merdarë, Vërmicë, Kullë, Hani i Elezit, Jarinjë dhe Dheu i Bardhë e ka konfirmuar edhe Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar. Ky institucion ka vendosur që të gjithë personat që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës dhe kanë rezultate negative për testin e koronavirusit - jo më të vjetra se katër ditë, të mos u nënshtrohen procedurave të vetizolimit.

Ata që nuk e kanë bërë testin, detyrohen të vetizolohen për shtatë ditë.

Menjëherë pas hapjes së kufirit, qytetarë të shumtë ia kanë mësyrë Shqipërisë nëpërmjet pikës kufitare në Morinë. Në këtë pikëkalim janë parë kolona të gjata të veturave të cilat kanë pritur për të shkuar në Shqipëri ngaqë Shqipëria ka hapur plazhet nga 1 qershori.

Me rekomandime të veçanta, po ashtu, punën e kanë filluar gjykatat.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) ka bërë me dije se, duke u bazuar në heqjen e kufizimeve të lëvizjes nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) dhe në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKShPK), ka marrë vendim që nga e hëna të fillojë puna në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, por pa praninë e mediave dhe të publikut, duke zbatuar rekomandimet e IKShPK-së për masat kundër virusit Covid-19. "Vendimi i plotë do të publikohet sapo të jetë gati. Anëtarët e KGjK-së aprovuan draft-propozimin për Planin emergjent për menaxhimin e krizës të përgatitur nga Komisioni për Administrimin e Gjykatave dhe Komisioni për Çështje Normative, qëllimi i të cilit është sigurimi i mbarëvajtjes së punës në sistemin gjyqësor të Kosovës duke iu përshtatur rrethanave emergjente. Gjithashtu, ky plan mund të shërbejë si dokument bazë për menaxhimin e krizave në të ardhmen duke përfshirë situatat e tjera emergjente shëndetësore, katastrofat natyrore apo rrethanat e kërcënimeve të sigurisë", ka njoftuar KGjK-ja.

Vendimin për lehtësimin e këtyre masave e ka marrë Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 38-të, një ditë më parë. Gjithashtu, nga data 8 qershor deri më 19 qershor bëhet kthimi i klasave të nënta nëpër shkolla dhe organizohet testi i arritshmërisë i cili do të mbahet më 23 qershor.

Kurse nga 15 qershori deri më 30 qershor bëhet kthimi i klasave të dymbëdhjeta nëpër shkolla dhe organizohet testi i maturës i cili do të mbahet më 4 korrik. "Rekomandimet nga aspekti shëndetësor për mbajtjen e distancës fizike, higjienës personale dhe masave të tjera mbrojtëse, janë përgatitur nga rekomandimet e IKShP-së dhe Ministria e Shëndetësisë. Rekomandimet specifike për hapjen e këtyre aktiviteteve janë pjesë e ministrive përkatëse", ka thënë kryeministri në detyrë Albin Kurti.

Kosova ka nisur lehtësimin e masave të izolimit me faza qysh më 4 maj. Deri më tani në Kosovë janë konfirmuar gjithsej 1 083 raste me koronavirus. Prej këtyre, 843 të infektuar janë shëruar, 30 kanë vdekur, kurse të tjerët ende janë të infektuar.

GJYKATA KUSHTETUESE KA PUBLIKUAR AKTGJYKIMIN E PLOTË PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT HASHIM TH

# TË MËRKURËN PRITET TË VOTOHET

EPOKA E RE Mal QORRAJ



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka dorëzuar në Kuvend nënshkrimet për thirrjen e seancës në të cilën pritet të votohet qeveria e re e drejtuar nga Avdullah Hoti. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka bërë me dije se në marrëveshje edhe me partnerët e koalicionit (AAK-në, Nismën dhe minoritetet) kanë kërkuar thirrjen e seancës së Kuvendit për të mërkurën në orën 11:00. Ai është shprehur i bindur se LDK-ja i ka votat për formimin e qeverisë së re. Ndërkaq presidenti i vendit, Hashim Thaçi, në një konferencë për media ka thënë se rrethanat aktuale në vend kërkojnë një qeveri funksionale dhe efektive. "Pres që sa më parë të themelohet qeveria e re. Kosova nuk e ka luksin të ketë vakuum në qeverisje", ka deklaruar Thaçi

Prishtinë, 1 qershor - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka publikuar të hënën aktgjykimin e plotë për dekretin e presidentit Hashim Thaçi nëpërmjet të cilit ka mandatuar Avdullah Hotin e LDK-së për formimin e qeverisë së re. Në dokument arsyetohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet të cilit iu dha e drejta e formimit të qeverisë, Lidhjes Demokratike të Kosovës, parti kjo e cila kishte dalë e dyta në zgjedhjet e fundit parlamentare të 6 tetorit të vitit të kaluar.

Në vendim thuhet se Gjykata Kushtetuese vendos "të shpallë, me shumicë votash, që Dekreti [nr. 24/2020] i 30 prillit 2020 i Presidentit të Republikës së Kosovës, përmes së cilit "Z. Avdullah Hoti, i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës", është në përputhshmëri me paragrafin (14) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] në lidhje me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

Gjykata konstaton se Vetëvendosja nuk ka dhënë asnjë indikacion për propozimin e mandatarit në shkresat e dërguara nga presidenti Hashim Thaçi. "Nga shkëmbimi i shkresave zyrtare në mes të presidentit dhe partisë politike fituese, në këtë rast jo vetëm që nuk ka propozim për mandatar, por nuk reflektohet as edhe një indikacion i vetëm lidhur me qëllimin për të propozuar një mandatar për kryeministër. Përkundrazi, kërkesa e këtyre shkresave është shpërndarja e Kuvendit dhe shpallja e zgjedhjeve të parakohshme. Këto kërkesa përjashtojnë mundësinë e propozimit të një mandatari për kryeministër", thuhet në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Në rast se merr votat e nevojshme në Kuvend, atëherë vendin për herë të parë do ta qeverisë një qeveri e cila nuk e ka në kuadër të vet partinë fituese të zgjedhjeve.

Më 28 maj, Gjykata Kushtetuese njoftoi se dekreti i presidentit Hashim Thaçi, për ta mandatuar Avdullah Hotin nga Lidhja Demokratike e Kosovës për postin e kryeministrit, është në përputhje me Kushtetutën dhe se mocioni i mosbesimit ndaj në qeverie në Kuvend nuk rezulton në shpërndarjen e detyrueshme të kuvendit.

Pas publikimit të plotë të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për mandatarin Hoti, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka dorëzuar në Kuvend kërkesën për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për votimin e ekzekutivit, i cili pritet të drejtohet nga Avdullah Hoti.

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka thënë se kanë kërkuar që seanca për votimin e qeverisë të mbahet të mërkurën, duke filluar nga ora 11:00. "Presim që të mërkurën ta kemi qeverinë e re", ka thënë Gashi në një konferencë për medie. Gashi ka thënë se kërkesa për mbajtjen e kësaj seance është dorëzuar së bashku me nënshkrimet e 61 deputetëve. Ai ka thënë se janë marrë vesh edhe me partnerët e koalicionit dhe se është shprehur i bindur se LDK-ja i ka votat e nevojshme për formimin e qeverisë së drejtuar nga Avdullah Hoti.

### Presidenti Thaçi thotë se rrethanat aktuale kërkojnë një qeveri funksionale dhe efektive

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar të hënën nga Kuvendi që ta formojë sa më shpejt qeverinë e re, e cila pritet të drejtohet nga Avdullah Hoti. Thaçi, në një konferencë për medie, pas publikimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me dekretin e tij për mandatarin për formimin e qeverisë, ka ftuar të gjitha partitë politike që ta respektojnë këtë aktgjykim. "U dëshmua edhe një herë se në Kosovë është pjekur demokracia dhe institucionet e pavarura funksionojnë me sukses. Tash është hapur rruga për

HAÇI PËR FORMIMIN E QEVERISË SË RE

# QEVERIA E UDHËHEQUR NGA HOTI



formimin e qeverisë së re. Shpresoj të jetë kapitull i ri për stabilitet dhe zhvillim. Kam qenë i kujdesshëm në çdo hap që të jetë në përputhje të plotë me Kushtetutën. Është me rëndësi që të respektohet rendi kushtetues dhe ligjor i Republikës së Kosovës. Është themel i funksionimit të shtetit", ka thënë Thaçi.

Ai ka shtuar se rrethanat aktuale në vend kërkojnë një qeveri funksionale dhe efektive. "Pres që sa më parë të themelohet qeveria e re pasi rrethanat kërkojnë një qeveri funksionale dhe efektive. Kosova nuk e ka luksin të ketë vakuum në qeverisje. Ftoj partitë politike dhe të nominuarin për kryeministër që t'i marrin përgjegjësitë", është shprehur Thaçi, duke shtuar se Kosova ka humbur shumë kohë duke ndërruar në tre-katër vjetët e fundit shumë qeveri e kryeministra. "Partitë kanë fituar, por qytetarët janë dëmtuar. Tani është koha për reflektim, stabilitet, unitet dhe punë të përbashkët", ka deklaruar ai.

Presidenti Thaçi ka pohuar se janë dy drejtime që institucionet e reja duhet t'u kushtohen. "Dy hapa janë urgjentë tani, të mbesim të kujdesshëm në përballje me pandeminë dhe rimëkëmbja ekonomike e vendit. Thërras të gjithë spektrin politik dhe komunitetin e biznesit që të punojnë në një plan ekonomik", ka thënë ai, duke theksuar se "duhet ta mbajmë shikimin në synimet tona strategjike, anëtarësim në NATO dhe BE".

Kurse Lëvizja Vetëvendosje ka nisur një peticion përmes të cilit kundërshtohet formimi i qeverisë së re dhe kërkohet shpallja e zgjedhjeve të reja parlamentare.

Diskutimet për qeveri të re kanë nisur pas rrëzimit të qeverisë, tashmë në detyrë, të udhëhequr nga Albin Kurti, përmes një mocioni të organizuar nga LDK-ja.

Në mesin e arsyeve për mocion kjo parti kishte përmendur dëmtimin e lidhjeve të Kosovës me Shtetet e Bashkuara dhe shkarkimin e Agim Veliut nga pozita e ministrit të Punëve të Brendshme.

# Kryetarët e komunave ankohen për mosinformim me kohë nga qeveria për hapjen e çerdheve

**Prishtinë, 1 qershor (ER)** - Në kuadër të masave lehtësuese ndaj Covid-19, Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka marrë vendim që nga 1 qershori të hapen çerdhet publike dhe private në vend. Por ndaj këtij vendimi kanë reaguar disa nga kryetarët e komunave, të cilët thonë se për këtë vendim janë njoftuar shumë vonë për arsye se atyre u duhet që paraprakisht të përgatiten për hapjen e çerdheve.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se nuk kanë marrë asnjë informatë zyrtare e as informatë mbi rregullat për hapjen e çerdheve. "Ne presim që Ministria e Arsimit ta qartësojë situatën dhe rregullat", ka thënë Ahmeti, i cili u ka bërë thirrje prindërve që më 1 qershor mos t'i dërgojnë fëmijët në çerdhe. "Prindër të nderuar, mos i dërgoni fëmijët në çerdhet publike dhe ato me bazë në komunitet në komunën tonë derisa t'i marrim vendimet dhe rregullat nga niveli qendror dhe derisa çerdhet përkatëse ku i keni fëmijët t'ju lajmërojnë për funksionimin e plotë. Çerdhet do të rihapen këto ditë, por ka nevojë për më shumë detaje e përgatitje", ka deklaruar Ahmeti.

Edhe kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka reaguar ndaj këtij vendimi për hapjen e çerdheve. Ai ka thënë se ky vendim i qeverisë është nonsens. "Në kopshte fëmijët ushqehen dhe pastrohen. Nuk mund të bëhen përgatitjet për të hënën në mëngjes kur lajmi jepet të dielën në orën 22:00. Prindërit të mos i dërgojnë fëmijët në kopshte", ka thënë Gjini, duke shtuar se nga e hëna kanë filluar përgatitjet për hapjen sa më të shpejtë të kopshteve me masat e duhura të sigurisë.

Edhe kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka njoftuar prindërit që pas konsultimit me drejtorin e DKA-së dhe drejtoreshën e IP "Rrita e Jonë", lidhur me rihapjen e institucioneve parashkollore për grupmoshat 0-5 vjeç, kanë vlerësuar se objekti i çerdhes duhet t'i nënshtrohet parapërgatitjes dhe procesit të dezinfektimit, pasi që për një kohë të gjatë ka qëndruar i mbyllur. "Si rezultat i kësaj, në Komunën e Obiliqit rihapja e çerdheve nuk do të ndodhë të hënën", ka thënë Gashi.

Edhe Komuna e Drenasit ka njoftuar prindërit që mos t'i dërgojnë fëmijët në çerdhe deri në një njoftim tjetër "për arsye se komuna në komunikimin zyrtar ende nuk ka pranuar asnjë vendim lidhur me rihapjen e çerdheve publike dhe atyre private. Komuna është në pritje të një vendimi ose qartësimi nga Ministria e Arsimit se si do të funksionojnë çerdhet dhe deri në marrjen zyrtare të një vendimi, çerdhet nuk do të hapen në Drenas. Në konferencë të Qeverisë në detyrë janë përmendur rregullat strikte për rihapjen e çerdheve, por ende ka nevojë për t'u qartësuar kjo gjendje se si do të hapen ato. Të nderuar qytetarë/prindër, çerdhet do të rihapen këto ditë, por presim nga niveli qendror për më shumë detaje lidhur më përgatitjet. Ju falënderojmë për mirëkuptim", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Drenasit.

Edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se njoftimin për hapjen e çerdheve për fëmijë e kanë marrë me vonesë nga Qeveria e Kosovës. "Për shkak të njoftimit me vonesë, me qëllim të përgatitjes më të mirë, ndërmarrjes së masave parandaluese kundër infeksionit Covid-19 dhe ruajtjes së shëndetit të fëmijëve tonë, çerdhja 'Nëna Zahide' nuk do të hapet të hënën", ka thënë kryetari Jashari.



# Klinika e Neurologjisë bëhet me dhomë për pacientë me sklerozë multiple



F. DËRMAKU

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Në Klinikën e Neurologjisë është përuruar dhoma për trajtimin e pacientëve me sklerozë multiple, investim i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) dhe kompania "Roche", e cila ka dhënë donacion për këtë dhomë.
Kryetari i Shoqatës së Neurologëve të Kosovës, Afrim Blyta, ka thënë se aktivizimi i këtij shërbimi është rezultat i punës dhjetëvjeçare të një ekipi të jashtëzakonshëm profesionistësh në Klinikën e Neurologjisë.
Blyta ka theksuar se mjekët tanë janë të përgatitur për të trajtuar raste të tilla sikurse mjekët në të gjithë botën. Ndërsa drejtori i Klinikës së Neurologjisë, Nexhmedin Shala, ka thënë se dhoma e re do të shërbejë si spital ditor. Ai është shprehur i bindur se QKUK-ja do ta ketë shumë shpejt edhe repartin e veçantë për trajtimin e personave me sklerozë multiple.
Shala i ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar për të bërë të mundur funksionalizimin e kësaj dhome. Kjo dhomë lëshohet në funksion në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Sklerozës Multiple, e cila është shënuar më 31 maj.

# Fillon puna në ambulancat specialistike

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Në kuadër të lehtësimit të masave, bazuar në Qarkoren Informative Nr. 11/2020 për informim të institucioneve shëndetësore publike dhe private, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, të hënën ka filluar puna në ambulancat specialistike, operacionet elektive dhe rastet e tjera joemergjente që ishin të ndaluar deri më tani.
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka njoftuar pacientët që kërkojnë shërbime shëndetësore në kuadër të klinikave të QKUK-së, por edhe spitaleve të përgjithshme, se për të hyrë në kuadër të objekteve shëndetësore domosdoshmërisht duhet të jenë të pajisur me maska dhe doreza, bazuar në planin e veprimit për rikthim gradual të shërbimeve shëndetësore të përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë.
ShSKUK-ja, po ashtu, ka njoftuar se të gjitha rastet që trajtohen paraprakisht duhet të caktojnë terminët, kurse në objekt hyjnë vetëm ata që kanë terminët, kurse të tjerët presin jashtë. Po ashtu, sipas këtij plani, kontrollet bëhen me distancë kohore prej 30 minutash, kurse është e ndaluar të krijohen tollovi në hyrje të objekteve.
ShSKUK-ja kërkon nga qytetarët që marrin shërbime shëndetësore mos të krijojnë tollovi, njëkohësisht apelon që të jenë të pajisur me maska dhe doreza dhe të ndihmojnë në ruajtjen e shëndetit publik.
Gjithashtu, ShSKUK-ja ka njoftuar pacientët që kanë terminët për realizim të procedurave diagnostike në Klinikën e Radiologjisë, se duhet të paraqiten sipas terminëve, kurse atyre që u ka kaluar termini, të lajmërohen në klinikë për të caktuar termin të ri.




# Vazhdojnë të ngrehen kapacitetet e institucioneve në luftën ndaj Covid-19



PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike në emër të Grupit Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidenteve ka pranuar donacion një softuer analitik nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë. Ky softuer do të jetë një ndihmesë për menaxhimin më të mirë të situatës së shkaktuar nga pandemia e virusit Covid-19. Këtë donacion e pranoi ushtruesja e detyrës së sekretares e MPBAP-së, Drita Hasani, e cila e falënderoi UNDP-në për bashkëpunim dhe mbështetjen e dhënë me këtë rast.
Në anën tjetër, zëvendëskoordinatorja e programit në UNDP, Marta Gazideda, ka theksuar se UNDP-ja do të vazhdojë t'i përkrahë edhe më tej institucionet e Republikës së Kosovës, me qëllim të përballimit sa më të mirë të pandemisë së koronavirusit.

# Bëhet thirrje për garantimin e të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët në Kosovë

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se më shumë se kurrë duhet të zotohemi për krijimin e mirëqenies dhe garantimin e të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët e Kosovës



PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Me rastin e 1 qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, liderët e institucioneve të vendit kanë uruar fëmijët për ditën e tyre, duke bërë thirrje për mirëqenie më të mirë dhe garantimin e të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët e Kosovës.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se më shumë se kurrë duhet të zotohemi për krijimin e mirëqenies dhe garantimin e të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët e Kosovës. Sipas tij, investimi në fëmijë është investim në të ardhmen. "Fëmijët janë e tashmja dhe e ardhmja e shoqërisë. Janë gjenerata më e re që do ta bëjë botën më të mirë. Prandaj, sot, në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, më shumë se kurrë duhet të zotohemi për krijimin e mirëqenies dhe garantimin e të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët e Kosovës. Investimi në fëmijë është investim në të ardhmen", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkaq kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se gati të gjitha prioritetet më të rëndësishme të shoqërisë dhe ekonomisë sonë ndërlidhen drejtpërdrejt me shëndetin, mirëqenien, edukimin dhe të drejtat e fëmijëve. Ai ka theksuar se fëmijët duhet të shihen si qytetarët e ardhshëm të demokracisë sonë të përbashkët.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve i ka dedikuar një shkrim rëndësisë së mirëqenies së fëmijëve, duke thënë se Kosova është e bekuar që ka popullatën më të re në Evropë. "Mirëqenia e fëmijëve është pasqyra më e qartë e suksesit të një shteti e shoqërie. Kosova është e bekuar që ka popullatën më të re në Evropë, por kjo na obligon të gjithëve që të fokusohemi në mbrojtje ligjore të moshave të vogla dhe në këtë kontekst, ne kishim propozuar edhe ligjin për shtesa të fëmijëve. Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve - 1 Qershori, na shërben si përkujtim, se detyrim i përbashkët, që t'u garantojmë atyre edukim të mirëfilltë, siguri dhe t'i mbrojmë nga çdo lloj abuzimi dhe dhune", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka uruar fëmijët me rastin e ditës ndërkombëtare të tyre. "Sot është dita më e rëndësishme për fëmijët, 1 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve. Në këtë ditë të veçantë shprehim përkushtimin tonë për t'u krijuar atyre kushte sa më të mira për shkollim, edukim, perspektivë, si dhe mundësi për t'i realizuar ëndrrat dhe dëshirat e tyre. Fëmijët janë e tashmja dhe e ardhmja e çdo shoqërie. Për ne si prindër ata janë frymëzimi ynë dhe pasuria më e madhe që e kemi. Urime 1 Qershori, fëmijë të dashur!", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

# KOMF-i lanson fushatën vetëdijesuese "Komuna ime, e drejta ime sociale"

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF ka mbajtur të hënën një konferencë për media, në të cilën ka publikuar raportin e monitorimit "Komuna ime, e drejta ime sociale" mbi procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale në Kosovë. Hapja e konferencës është bërë nga Donjeta Kelmendi nga KOMF, e cila i ka uruar të gjithë fëmijët për një jetë dinjitoze dhe për garantim të plotë të të drejtave të tyre. Kelmendi ka theksuar se, edhe pse mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është e garantuar me ligj për të gjithë fëmijët dhe qytetarët në nevojë, jo të gjithë kanë qasje dhe përfitojnë nga shërbimet.

Pas fjalës hyrëse të saj, Bukurezë Surdulli nga KOMF ka prezantuar të gjeturat dhe rekomandimet e Raportit të Monitorimit mbi Procesin e Decentralizimit të Shërbimeve Sociale për vitin 2019, i cili është realizuar në shtatë komuna të Republikës së Kosovës. Raporti i monitorimit të decentralizimit të shërbimeve sociale vërteton se procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale nuk është përmbyllur edhe pas dhjetë vjetësh. Arsyeja kryesore e moszbatimit të këtij procesi është mungesa e vullnetit politik si nga ana e nivelit qendror, po ashtu edhe nga ana e nivelit komunal.

Faktorë të tjerë që kanë penguar zbatimin e plotë të decentralizimit janë mungesa e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, mungesa e një skeme të kontraktimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar, kapacitetet e kufizuara të komunave për menaxhim të shërbimeve sociale, llogaridhënia e ulët, paqartësitë në ndarjen e përgjegjësive mes nivelit qendror dhe komunal, paqartësitë në ndarjen e funksioneve të monitorimit dhe inspektimit të shërbimeve sociale etj.

Gjatë konferencës u prezantuan edhe rekomandimet kryesore për implementimin e të gjeturave të monitorimit.




Pas prezantimit të të gjeturave kryesore të Raportit të Monitorimit, KOMF lansoi fushatën me karakter informues dhe vetëdijesues "Komuna ime, e drejta ime sociale", e cila ka për qëllim që t'i informojë qytetarët për decentralizimin e shërbimeve sociale në Kosovë dhe ta promovojë implementimin e plotë të këtij procesi.

Ky aktivitet u mundësua në kuadër të projektit "Aksioni i përbashkët për decentralizim", projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, i cili implementohet nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF në partneritet me Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror - OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KMOP.

# Ndalet tregtia Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 1 QERSHOR - Pesëmbëdhjetë kamionë me mallra nga Serbia nuk janë lejuar të hyjnë në territorin e Kosovës për shkak të zbatimit të vendimit të fundit të Qeverisë në detyrë të Republikës se Kosovës për ashpërsimin e masave për reciprocitet me këtë shtet.

Qeveria në detyrë e Kosovës ka vendosur që asnjë maune nga Serbia të mos hyjë në Kosovë nëse në dokumentet e saj nuk shkruan Republika e Kosovës.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, të dielën ka shkruar në "Facebook" se "edhe emri 'Kosovë' është kushtetues, mirëpo së fundmi Serbia ka ndërruar qasje duke kushtëzuar përdorimin e emrit 'Republika e Serbisë'. Ne i kundërvihemi me masë reciproke", ka shkruar Kurti.

Zëdhënësi i Doganave të Kosovës, Adriatik Stavileci, për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se deri tani janë kthyer 11 maune dhe se të gjitha kthimet "kanë të bëjnë me aplikimin e masave të reciprocitetit sipas pikës 1, respektivisht 1.1 dhe 1.3 dhe, gjithashtu, edhe pikës 3 të vendimit të qeverisë.

Pika tre nënkupton që operatorët ekonomikë nga Serbia duhet të pajisen me leje hyrëse për secilin automjet të transportit të mallrave që hyjnë në Republikën e Kosovës nga Zyra Ndërlidhëse e Republikës së Kosovës në Serbi.

Në Zyrën Ndërlidhëse të Republikës së Kosovës në Serbi thonë se rreth 20 kompani serbe deri më tani kanë kërkuar leje nga kjo zyrë për eksportin e mallrave në Kosovë sipas rregullave të reja tregtare të miratuara të shtunën më 30 maj.

Jetish Jashari nga kjo zyrë për Radion Evropa e Lirë ka thënë se "është një proces që zgjatë dhe ne jemi duke marrë kërkesa; kështu që nuk kemi numra të fundit se sa kompani kanë kërkuar leje që mallrat e tyre të hyjnë në Kosovë". "Por, mund të konfirmoj me siguri se ka më shumë se dhjetë ose njëzet kompani që kanë dërguar kërkesa në Zyrën Ndërlidhëse të Kosovës në Serbi. Ne ua kemi përcjellë kërkesat institucioneve tona kompetente të cilët do të vendosin për secilën kërkesë individualisht, sepse ato duhet të plotësojnë kushte të caktuara në mënyrë që mallrat të hyjnë në Kosovë. Sapo ta sigurojnë lejen ata do të jenë në gjendje t'i transportojnë mallrat", ka thënë Jashari.

Qeveria në detyrë e Kosovës më 28 maj ka vendosur masa tregtare shtesë për Serbinë, duke ndaluar përdorimin e dokumenteve për produktet bujqësore dhe industriale me "emra vendesh që përmbajnë elemente që janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe që përmbajnë elemente që mohojnë pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës".

### Ndalet edhe eksporti i Kosovës për në Serbi

Sipas vendimit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë obligohet ta përdorë stemën dhe emrin Republika e Kosovës në certifikatat fitosanitare dhe veterinare.

Zëdhënësi i kësaj Agjencie, Lamir Thaçi, për Radion Evropa e Lirë ka treguar se të gjitha vendimet që nxirren nga autoritetet shtetërore "ne jemi vetëm zbatues të tyre, duke përfshirë edhe vendimin e fundit të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës". "Të gjitha kriteret e vendosura sipas pikave të vendimit të qeverisë jemi duke i zbatuar gjatë kontrollit të brendshëm dhe atij kufitar", ka thënë Thaçi, i cili ka treguar se gjatë ditës së hënë nuk ka pasur ndonjë kërkesë nga kompanitë e Kosovës për të eksportuar produkte në Serbi.

Një nga kompanitë e Kosovës që eksporton mallra në Serbi është "Inter-Company" nga Podujeva. Kjo kompani mbjell luledielli dhe prodhimin e kësaj bime e përdor për prodhimin e vajit dhe një pjesë të lëndës së parë e eksporton në Serbi.

Pronari i kësaj kompanie, Sulejman Konushevci, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se pas vendimit të ri për reciprocitet nuk ka tentuar të eksportojë, pasi thotë se Serbia nuk njeh që në certifikata fito-sanitare ku shkruhet Republika e Kosovës, por vetëm Kosova. "Nuk kam tentuar të eksportoj sepse qeveria na ka kushtëzuar që në certifikata duhet të shkruhet Republika e Kosovës e ata (autoritetet serbe) nuk e pranojnë. Kështu që nuk kemi tentuar sepse vetëm duhet të bëhen shpenzime që mauna të shkojnë në kufi dhe të mbesin aty", ka treguar Konushevci.

Më 1 prill kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka hequr taksën 100 për qind ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës të vendosur në vitin 2018 nga qeveria Haradinaj, kurse masën ndaj mallrave serbe e ka zëvendësuar me reciprocitet. Vendimi i ri ka të bëjë me moslejimin e hyrjes së mallrave serbe të cilat nuk kanë dokumente që i referohen Kosovës me emrin e saj kushtetues, Republika e Kosovës. Ky vendim ka nxitur reagime në Serbi.

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Tregtisë i Serbisë, Rasim Lajiq, ka thënë se që nga ndërmarrja e masave të reja tregtare nga Qeveria në detyrë e Kosovës, kamionët nga Serbia po kthehen prapa në vendkalimet në Kosovë sepse "asnjëri nuk i plotëson kushtet e kërkuara nga Dogana e Kosovës".

### BE-ja kundër masave të reja

Përveç Serbisë, ndaj vendimit të fundit të qeverisë ka reaguar edhe Brukseli. Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë dhe për çështje të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajçak, ka shprehur zhgënjimin për masat e reja të reciprocitetit ndaj Serbisë të cilat i ka miratuar Qeveria në detyrë e Kosovës. Këtë masë e ka kundërshtuar edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe i mandatuari i Lidhjes Demokratike të Kosovës për kryeministër, Avdullah Hoti, duke thënë se "veprimet e fundit të Qeverisë në detyrë të Kosovës "nuk e ndihmojnë vendin, por e vënë atë në kurth", ka thënë Hoti.

# BQK-ja: Ende nuk është marrë vendim për shtyrje të mëtutjeshme të kësteve të kredive

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka dalë me sqarim për publikun në lidhje me zgjatjen e afatit të kësteve të kredive. Sipas BQK-së, ende nuk është marrë vendim për shtyrje të mëtutjeshme të kësteve të kredive. "Gjatë ditës së shtunë në shumë portale të vendit është publikuar lajmi me titull: 'BQK-ja shtyn afatin e kësteve të kredive'. Me qëllim të informimit të drejtë të publikut, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dëshiron të sqarojë edhe një herë se nuk është marrë asnjë vendim i ri për shtyrje të sërishme të afatit të pagesës së kësteve të kredive. Edhe një herë sqarojmë se në fuqi mbetet vendimi që afati i shtyrjes së pagesës së kësteve të kredive të jetë 3 muaj, nga data 16 mars deri më 16 qershor 2020 për kredimarrësit të cilët kanë hasur vështirësi financiare si rezultat i rënies së të hyrave personale apo biznesore për shkak të Covid-19. Sikurse kemi informuar edhe më herët, gjatë kësaj periudhe institucionet kredidhënëse nuk do të aplikojnë interes ndëshkues, nuk do të aplikojnë ndryshim të klasifikimit kreditor ndaj kredimarrësve dhe BQK-ja nuk do të kërkojë provizione shtesë nga këto institucione për kreditë e shtyra", thuhet në njoftimin e BQK-së.

Sipas këtij njoftimi, interesi i rregullt për këta tre muaj do të përllogaritet, pagesa e të cilit do të shpërndahet për periudhë së paku gjashtëmujore apo më herët, në rastet e maturimit të kredive para kësaj periudhe. "BQK-ja kërkon nga institucionet kredidhënëse ta zbatojnë këtë kërkesë, me qëllim të lehtësimit dhe të ruajtjes së likuiditetit të kredimarrësve gjatë kësaj periudhe të ndërprerjes së aktivitetit të shumë veprimtarive ekonomike për shkak të pandemisë. BQK-ja do të vazhdojë së monitoruari me shumë kujdes zhvillimet ekonomike dhe ato në sektorin




financiar në mënyrë që ta japim kontributin tonë të mëtejmë në rimëkëmbjen e ekonomisë, por gjithmonë duke vendosur në plan të parë ruajtjen e stabilitetit financiar që është edhe detyra parësore e BQK-së", thuhet në fund të sqarimit nga Banka Qendrore e Kosovës.

# Rifillojnë punën kafiteritë, kërkohet ndihma e institucioneve për ta parandaluar bankrotimin e tyre



Sektori i gastronomisë ka filluar punën të hënën. Ky lajm është mirëpritur nga nënkryetari i Shoqatës së Gastronomisë, Veton Zuka dhe nga pronarët e kafiterive në kryeqytet, të cilët kanë kërkuar mbështetje institucionale sa i përket pakos ekonomike, pasi humbjet për këtë sektor llogaritet të jenë të mëdha

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Kafiteritë, restorantet, qendrat tregtare dhe taksitë kanë rifilluar punën të hënën. Rifillimi i punës është mirëpritur nga bizneset dhe Shoqata e Gastronomisë, ku është kërkuar që Qeveria e Kosovës t'i përkrahë në procesin e rimëkëmbjes në mënyrë që mos të bankrotojnë shumica prej tyre.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në një konferencë për medie ka thënë se është shfuqizuar vendimi që kishte mbyllur këto aktivitete. "Kemi shfuqizuar edhe pikën 6 me të cilën mbylleshin kafiteritë, restorantet dhe qendrat tregtare. Pra, nga nesër [e hënë] hapen", ka thënë Kurti.

Lajmi për rifillimin e punës të sektorit të gastronomisë është mirëpritur edhe nga Shoqata e Gastronomëve. Nënkryetari i Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës, Veton Zuka, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është mirëpritur vendimi për rihapjen e kafiterive. "Është lajm i mirë rifillimi i punës për kafiteritë, pasi kemi mundësi ta zhvillojmë aktivitetin. Ky lajm është i mirëpritur nga të gjitha bizneset jo vetëm për sektorin e gastronomisë. Shpresojmë se do të kemi një fillim të mirë, por tani duhet ndihma e qeverisë për të gjithë ne që kemi qenë të dëmtuar që tre muaj", ka thënë Zuka.

I pyetur se sa llogaritet të jenë dëmet e shkaktuar nga pandemia Covid-19, ai ka thënë se ende nuk kanë shifra të sakta për këtë por, sipas tij, humbjet janë të mëdha. Zuka ka pohuar se nëse ky sektor nuk merr mbështetje nga qeveria do të rrezikohet nga bankrotimi. "Nuk kemi ende shifra zyrtare, por humbjet janë të mëdha, që i bie se jemi para bankrotimit nëse qeveria nuk ndërmerr masa. Një plan i ministrit Bislimi është i mirë dhe na konvenon që të rimëkëmbemi, por tani kemi problemin politik dhe vjen në pikëpyetje zbatimi i atij plani. Nëse nuk marrim ndihmë nga shteti, ne rrezikojmë të falimentojmë, sepse jemi në borxhe dhe bankat na kanë vendosur në listë të zezë. 90 për qind e tyre kanë obligime ndaj bankave, pra rimëkëmbja është problematike", ka thënë ai.

Sa iu preket vendeve të punës, Zuka ka thënë se edhe pse ende nuk mund t'i dinë shifrat e sakta, nga informatat që kanë shumica kanë rifilluar punën me stafin që kanë pasur.




## Mushkolaj: Pakoja emergjente nuk është e mjaftueshme

Shpëtim Mushkolaj, i cili është pronar i kafiterisë "Limi" në Prishtinë, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se vendimi për rifillimin e punës është i mirëpritur por, sipas tij, është e nevojshme ndihma institucionale. "Rifillimi i punës është i mirëpritur dhe nuk presim të kemi fitim të mëhershëm, por keni parasysh se edhe kemi investime shtesë tashmë", ka thënë ai.

Mushkolaj ka theksuar se pakoja e rimëkëmbjes ekonomike nga Qeveria e Kosovës lë për të dëshiruar dhe se ndihma duhet ofruar për pesë muaj pasi humbjet janë shumë të mëdha. Ndërkaq sa iu përket rrethanave politike, ai ka thënë se lidershipi i vendit duhet të tregojë përkushtim për sektorin privat, gjegjësisht sektorin e gastronomisë dhe mos të mungojë mbështetja institucionale. "Pakoja e rimëkëmbjes është shumë e mangët. Do të duhej të vazhdonte përkrahja për pesë muaj sepse humbjet janë të mëdha. Në kohën kur nuk kemi punuar kanë vazhduar shpenzimet e ujit, rrymës, qeras dhe pagave të punëtorëve. Punëtorët tanë i kanë marrë pagat vetëm për muajin e parë 170 euro, e që nuk është e mjaftueshme", ka thënë Mushkolaj, duke apeluar që qeverisja e ardhshme ta ketë për bazë gjendjen e sektorit të gastronomisë. "Qeveria e ardhshme duhet ta ketë parasysh mbështetjen institucionale dhe mos të ndalet pakoja e rimëkëmbjes, por mundësisht të rritet ndihma. Sektori ynë në këtë kohë pandemie s'ka gjeneruar fare të hyra", u shpreh ai.

Ministri në detyrë i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, në një konferencë për media ka prezantuar Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike, vlera e së cilës pritet të jetë 1.26 miliard euro. Sipas Bislimit, fokusi kryesor i kësaj pakoje do të jetë mbështetja e secilit biznes me kredi, i cili gjatë kësaj periudhe pandemie ka pasur rënie të aktivitetit ekonomik. Në kuadër të kësaj pakoje janë paraparë edhe 11 masa të cilat do të zbatohen gradualisht nëse kjo pako aprovohet nga Qeveria e Kosovës. Autoritetet në Kosovë kanë shpallur gjendje emergjente për shëndetin publik me qëllim të parandalimit të përhapjes së kësaj sëmundjeje.

## Komuna e Prishtinës nis shpërndarjen e shujtave



PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se pas lehtësimit të masave kundër Covid-19, shujtat për qytetarët në nevojë do të shpërndahen çdo ditë, duke filluar nga ora 17:00. Me këtë rast, Ahmeti ka thënë se është e domosdoshme mbajtja e distancës nga personat të cilët do të shërbehen me shujta. "Me fazën e tretë të hapjes dhe lirimin e qarkullimit, prej sot shujtat do të shërbehen prej orës 17:00 në dy lokacionet, 'Tophane' e 'Aktash'. Ju rikujtojmë që është e domosdoshme mbajtja e distancës sociale të personave që shërbehen me këto shujta", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

# Kolaj: Komuna e Gjakovës e ka menaxhuar mirë situatën me pandeminë Covid-19

GJAKOVË, 1 QERSHOR (ER) - Ushtruesi i detyrës i drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Gjakovës, njëherësh drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Ferdinand Kolaj, ka thënë se kjo komunë e ka menaxhuar mirë situatën me pandeminë me Covid-19. Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", Kolaj ka thënë se numri i të infektuarve me këtë virus në Gjakovë ka shkuar në 16. Sipas tij, në këtë kohë pandemie në Gjakovë janë ndihmuar 2 400 familje.

Kolaj ka folur edhe për projektet që janë realizuar në këtë kohë në Komunën e Gjakovës. "Gjatë kësaj kohe sa është qeveria Gjini dhe unë si drejtor i Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Gjakovës i kemi realizuar disa projekte nga kjo drejtori, të cilat janë të lidhura me fushën e turizmit si një nga sektorët që ndikon shumë në zhvillimin ekonomik", është shprehur Kolaj.



**"Epoka e re":** *Z. Kolaj, si e keni menaxhuar situatën e pandemisë në komunën tuaj, duke pasur parasysh se keni pasur edhe të infektuar nga Covid-19?*

**Ferdinand Kolaj:** Situata në Komunën e Gjakovës është menaxhuar mirë në përgjithësi. Pothuajse jemi ndër komunat që kemi pasur numrin më të vogël të infektuarve me Covid-19.

**"Epoka e re":** *Sa kanë qenë kapacitetet komunale për t'u dalë në ndihmë qytetarëve të Gjakovës në aspektin social, dhe sa keni pasur përkrahje nga institucionet qeveritare?*

**Ferdinand Kolaj:** Komuna e Gjakovës, falë disa donatorëve të cilët besuan në punën e Komunës së Gjakovës dhe që ishin të gatshëm që donacionet e tyre t'ia besojnë komunës, kanë përfituar mbi 2 400 familje.

**"Epoka e re":** *Sa e ka ndihmuar Ministria e Shëndetësisë me gjëra sanitare e shëndetësore spitalin "Isa Grezda" dhe shtëpitë e shëndetit?*

**Ferdinand Kolaj:** QKMF-ja është nën menaxhimin e Komunës së Gjakovës dhe gjatë kohës së pandemisë kemi marrë material të nevojshëm për luftën ndaj Covid-19, por aty ku nuk ka pasur mundësi Ministria e Shëndetësisë, në disa raste ne si komunë i kemi siguruar materialet e nevojshme, ndërsa spitali 'Isa Grezda' është në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë. Por, sa jam i njoftuar, edhe ata kanë marrë disa herë material të domosdoshëm për luftën ndaj Covid-19.

**"Epoka e re":** *Sa ka qenë numri i të infektuarve në Komunën e Gjakovës? Dhe, siç dihet, një grua e infektuar ka vdekur.*

**Ferdinand Kolaj:** Numri i të infektuarve në total ka qenë 16. Një grua shtatzënë, fatkeqësisht, ka humbur jetën, ndërsa 15 të tjerë janë shëruar dhe që nga data 18 maj nuk kemi pasur raste të reja me Covid-19 në Komunën e Gjakovës.

**"Epoka e re":** *Ju jeni edhe drejtor i Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Gjakovës. Cilat janë të arriturat e kësaj drejtorie kur dihet se keni përfunduar shumë projekte që i kanë munguar Gjakovës?*

**Ferdinand Kolaj:** Gjatë kësaj kohe sa është qeveria Gjini dhe unë si drejtor i Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Gjakovës i kemi realizuar disa projekte nga kjo drejtori, të cilat janë të lidhura me fushën e turizmit si një nga sektorët që ndikon shumë në zhvillimin ekonomik. Këto projekte po japin rezultatet e tyre duke pasur parasysh se çdo ditë e më shumë po vizitohen nga qytetarët e Kosovës.

**"Epoka e re":** *A keni planifikuar projekte të reja për t'i zbukuruar vendet atraktive të shumta që i ka Gjakova?*

**Ferdinand Kolaj:** Ne po vazhdojmë edhe me disa projekte të cilat do të jenë shumë atraktive dhe do të ndikojnë në ardhjen e vizitorëve në qytetin e Gjakovës.

## Rrënohen objektet e vetmisë në Obiliq

OBILIQ, 1 QERSHOR (ER) - Komuna e Obiliqit, në bashkëpunim me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), ka filluar procesin e rrënimit të objekteve të vetmisë të cilat gjenden në qendër të qytetit të kësaj komune. Për të parë nga afër këtë proces ishte i pranishëm kryetari i Obiliqit, Xhafer Gashi, i cili ka falënderuar KEK-un për ofrimin e makinerive të rënda për rrënimin e këtyre objekteve. "Këto objekte të vjetruara dhe të demoluara nuk kanë plotësuar kushtet për jetesë. Në këtë formë ne si komunë kemi marrë vendim për rrënimin e tyre. Obiliqi prej tani frymon ndryshe. Kjo pjesë po hap rrugë për investime të reja për ndërtimin e sheshit 'Adem Preniqi'. Obiliqi po merr pamje të re, për të cilën secili qytetar ka ëndërruar. Obiliqi po ndryshon", është shprehur Gashi.



# Stabiliteti i vendit ka çmim më të lartë se ambicia për pushtet

Albin Kurti disa herë iu ka referuar figurës së Hasan Prishtinës si model i politikëbërjes, andaj do të ishte e udhës që edhe me këtë rast ta ndiqte shembullin e tij kur dorëzoi kolltukun e kryeministrit (më 10 dhjetor 1921) për t'i ikur gjakderdhjes brendashqiptare. Pra, figura dhe vepra e kolosit Hasan Prishtina le të përdoret edhe kësaj radhe jo vetëm si model politikëbërjeje, por edhe si pikë referimi e reflektimi për të vepruar ngjashëm si ai edhe në momentet kur duhet dorëzuar pushteti. Madje edhe atëherë kur pushteti të merret nga duart në mënyrë arbitrare e joparimore



Nga Mehmet PRISHTINA

Askush nuk mund ta zhbëjë vendimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila i jep të drejtë dekretimit të Avdullah Hotit për kryeministër nga ana e presidentit Thaçi. Gjithashtu, është proces i pakthyeshëm tashmë formimi i një kabineti të ri qeverisës, i kryesuar nga LDK-ja në koalicion me AAK-në, Nismën, Lista Serbe dhe komunitetet e tjera.

Kosova nga një krizë e papërfunduar shëndetësore po futet në një situatë të re dhe të panjohur politike dhe ditët në vazhdim do të jenë mjaft dramatike për faktin se përmbysja e skenës politike po ndodhë në kohën kur polarizimi në shoqërinë kosovare ka arritur kulmin.

Lëvizja Vetëvendosje tash më e ka bërë të ditur se e konteston legjitimitetin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, kurse aktivistët e saj kanë paralajmëruar protesta. Dinamika e ngjarjeve në vijim mund të sjell një dizajn të ri social e publik nëpër rrugët dhe sheshet e Kosovës.

Nga zgjedhjet e fundit parlamentare, që u mbajtën më 6 tetor 2019, pa u bërë ende 8 muaj të plotë, Kosova do të drejtohet nga një qeveri e re, por tash pa zgjedhje. Mandati i kësaj qeverie pritet të jetë i limituar në disa çështje neuralgjike, ku dominojnë raportet e pa mbyllura me Serbinë. Për shkak të kësaj teme të imponuar që po rri në qafë si një gurë i rëndë, qytetarët e Kosovës nuk do të mund të presin që çështjet e tyre do të jenë parësore, siç janë zbutja e varfërisë, ulja e papunësisë, zhvillimi ekonomik, lufta kundër krimit dhe korrupsionit, liberalizimi i vizave etj.

Pra ngutia dhe gatishmëria për të formuar qeverinë e re, lidhet më tepër me një problem të jashtëm, jo pak serioz, siç është Serbia, e më pak me hallet e problemet e brendshme që i kanë qytetarët e Kosovës.

Qeveria e Albin Kurtit erdhi me premtimin se problemet brendshme të kosovarëve do të jenë prioritet, mirëpo në rrugë e sipër, pa u bërë as dy muaj, kjo agjendë u tregua e parealizueshme për shkak të rrethanave të krijuara që tash më të gjithë i dimë.

Shumë kush beson se Albin Kurti u rrëzua për shkak të një mocioni mosbesimi i iniciuar nga partneri i deridjeshëm - LDK. Por në fakt, Albin Kurtin e rrëzoi ambicia e tij për të bërë ndryshime që nuk ishin bërë tash e njëzetë vite në skenën politike të Kosovës. Për këtë ambicie ai nuk pati partner, ndonëse ka shumë veta që e mbështesin këtë ambicie të tij, ashtu siç ka edhe të tjerë që e kundërshtojnë atë. Por, këta të fundit kundërshtimin e tyre po e mbështjellin me një alibi të tejdukshme që lidhet me aleatin tonë strategjik - Amerikën. Të gjithë ata që i përjetonin si lajme të këqija shkarkimet e bordeve problematike të kompanive shtetërore e publike si dhe paralajmërimin për konfiskim të pronave të atyre që në mënyrë të paligjshme ishin pasuruar, kishin gjetur një strehë - Amerikën, të cilën e përdornin si pëlhurë toreadorësh për të dezorientuar dhe amortizuar fuqinë e shtetit ligjor.

Në shtetet demokratike, transferet e pushteteve bëhen paqësisht dhe me elegancë. Deri më tani, edhe Kosova ka treguar kapacitet të mjaftueshëm demokratik për të pranuar realitetin e ri politik si një rotacion i normal. Ka pasur shumë kontestime e ankesa, por në fund është pranuar rezultati i atyre që i kanë fituar zgjedhjet.

Në kontekstin e tanishëm kosovar, Albin Kurti dhe partia e tij po ndjehen të zhgënjyer nga ky devijim i proceseve demokratike, duke pretenduar se pushtetet formohen vetëm përmes zgjedhjeve, e jo përmes tryezave të bisedimeve dhe ridizajnimit të shumicës së re në Kuvend. Këtë zhgënjim ata e shprehën edhe në adresë të Gjykatës Kushtetuese nga e cila kërkuan që ta "interpretojnë e jo ta shkruajnë Kushtetutën".

Sikur gjithë kjo retorikë të kufizohej vetëm brenda deklarimeve verbale, do të ishte gjithçka në rregull, por nëse ndodhë ajo çka është paralajmëruar, atëherë Kosova ka rrezik të rrëshqasë në një krizë edhe më të madhe. Atëherë Kosova sërish do të targetohet si një pikë problematike e rajonit e cila nuk po mundet të konsolidohet si shtet dhe si shoqëri. Ky imazh ka kosto të lartë negative dhe Albin Kurti në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojë që të ndodhë. Ai disa herë iu ka referuar figurës së Hasan Prishtinës, si model i politikëbërjes, andaj do të ishte e udhës që edhe me këtë rast të ndiqte shembullin e tij .

Sikundër dihet Hasan Prishtina më 7 dhjetor 1921 u zgjodh nga Kuvendi Popullor Shqiptar, Kryeministër dhe Ministër i Jashtëm, por më 10 dhjetor 1921 ai jep dorëheqje pas kundërshtimeve të disa deputetëve që i kryesonte Ahmet Zogu. Kështu, për të shmangur gjakderdhjen midis shqiptarëve, Hasan Prishtina pranon të largohet nga kolltuku i Kryeministrit dhe mbetet vetëm deputet i atij Kuvendi.

Pra, figura dhe vepra e kolosit Hasan Prishtina le të përdoret edhe kësaj radhe jo vetëm si model politikëbërjeje, por edhe si pikë referimi e reflektimi për të vepruar ngjashëm si ai edhe në momentet kur duhet dorëzuar pushteti. Madje edhe atëherë kur pushteti të merret nga duart në mënyrë arbitrare e joparimore. Sepse kurrfarë çmimi nuk ka stabiliteti i vendit dhe raportet brendakombëtare, në krahasim me ambiciet për pushtet, qofshin ato edhe shumë qëllimmira.

Para ardhjes në pushtet, Albin Kurti demonstroi një opozitarizëm të fuqishëm, i cili për shumëkënd ishte edhe i kritikueshëm. Por realiteti tregoi se ai opozitarizëm prodhoi rezultat politik që u kurorëzua me fitoren në zgjedhjet e 6 tetorit të vitit të kaluar.

Tani, kur Albin Kurti e provoi pushtetin dhe kur kauza e tij politike e kombëtare u ballafaqua me sfidat që krijon pushteti, është në logjikën e gjërave që edhe opozitarizmi i tij tash e tutje të mos e ndjek stilin dhe metodologjinë e mëparshme, sepse mbështetja popullore për të u dëshmua edhe gjatë kohës sa ai ishte kryeminstër në detyrë. Kundërshtarët e tij, madje, do të donin ta shihnin sërish Albin Kurtin të barrikaduar në kampin opozitar me mjete radikale, sepse vetëm në këtë mënyrë ata llogarisin në rrënimin e imazhit të tij para popullit.

Protestat paqësore e dinjitoze të qytetarëve të pakënaqur, janë pjesë e demokracisë dhe këtij rregulli nuk mund t'i ikë as Kosova. Por protesta më substanciale do të bëhej atëherë kur opozita bashkë me mediat dhe shoqërinë civile inventarizon të gjitha devijimet e pushtetit, duke faktuar me prova e argumente gjithçka që është në dëm të interesave të Kosovës. Në të kaluarën LV këtë ka ditur ta bëjë më së miri, por duke shmangur me çdo kusht frymën e mosdurimit dhe linçimit në komunikimet publike, sepse ato përpos polarizimeve dhe acarimeve, nuk sjellin kurrfarë dobie për mirëqenien e vendit.

Në ditët në vijim na mbetet të presim se si do ta dizajnohet pushteti i ri, duke nënkuptuar edhe agjendën që do ta bëjë publike. Sigurisht që do të hapet një kapitull i ri në politikëbërjen e Kosovës, kurse ajo që nuk do të përsëritej në të ardhmen është që opozita e re të mos sillet si kjo opozita e deridjeshme, e cila prej ditës së parë të Qeverisë Kurti kërkonte përmbushjen e objektivave që nuk ishin realizuar këtu e 20 vite më parë (!). Opozita e re, nuk duhet të imitojë opozitën e vjetër, e cila që në ditën e parë të votimit të Qeverisë në Parlament, u lexuan dhjetëra referate të shkruara që fare nuk kishin të bënin me programin qeverisës.

Një shtet quhet normal kur kohezioni social dhe politik është në përputhje me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Kosova ka nevojë për më shumë kohezion të brendshëm dhe kjo arrihet vetëm nëse shkalla e polarizimit politik reduktohet në maksimum.



# Në ShBA vazhdojnë protestat për vrasjen e afrikano-amerikanit

Uashington, 1 qershor - Në disa qytete të Shteteve të Bashkuara vazhduan të dielën protestat për vrasjen e një afrikano-amerikani në Mineapolis të Minesotës.
Qindra njerëz u mblodhën në një park pranë Shtëpisë së Bardhë në Uashington duke brohoritur "Jeta e afrikano-amerikanëve ka vlerë", "Duart lart, mos qëllo" dhe "Pa drejtësi nuk ka paqe".
Disa prej tyre hodhën shishe plastike në drejtim të policisë.
Pasi protestuesit ndezën dy zjarre pranë parkut, policia reagoi me gaz lotsjellës.
Në Nju Jork së paku dy makina u dogjën, derisa mijëra njerëz marshuan në lagje të ndryshme.
Afrikano-amerikani George Floyd, 46-vjeçar, vdiq javën e kaluar, pasi u ndalua nga oficerët policorë - njëri prej të cilëve i bëri presion me gju në qafë.
Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e cilësoi vdekjen e Floydit si "tragjedi të rëndë" që e ka mbushur vendin me zemërim dhe pikëllim, por tha se administrata e tij nuk do të tolerojë që demonstratat të shndërrohen në dhunë.
Trazirat filluan në Mineapolis dhe u përhapën në të gjithë ShBA-në që nga vdekja e Floydit më 25 maj. Gjatë fundjavës, demonstrues në Kanada, Mbretëri të Bashkuar dhe Gjermani u mblodhën për të shfaqur mbështetje për protestat.



# Kryeministri armen dhe familja e tij infektohen me koronavirus



Jerevan, 1 qershor - Kryeministri i Armenisë, Nikol Pashinian dhe katër anëtarë të familjes së tij të ngushtë kanë dalë pozitivë në testet me Covid-19. "Fatkeqësisht, rezultatet e testeve tona janë pozitive", ka thënë Pashinian gjatë një adresimi të drejtpërdrejtë në "Facebook".
Pashinian, 45-vjeçar, jeton me gruan dhe tri vajzat e tyre, ndërsa djali shërben në ushtri dhe nuk jeton me familjen. Pashinian ka pohuar se nuk ka simptoma, porse ka vendosur të testohet pasi ka planifikuar një vizitë te trupat ushtarake. Ai ka theksuar se është vetizoluar në rezidencën e tij dhe se do të vazhdojë ta udhëheqë qeverinë nga atje.
Që nga shpërthimi i Covid-19 në Armeni në muajin mars, ky vend ka identifikuar mbi 9 400 raste të të infektuarve dhe 139 viktima.

# Moska i lehtëson masat e izolimit pas nëntë javësh

Moskë, 1 qershor - Autoritetet në Moskë i lehtësuan masat e izolimit kundër koronavirusit, edhe pse numri i rasteve vazhdon të rritet. Parqet dhe qendrat tregtare në kryeqytetin rus u rihapën dhe njerëzit u lejuan të dalin jashtë për shëtitje dhe ushtrime të kufizuara, për herë të parë në nëntë javë.
Presidenti rus, Vladimir Putin, tha javën e kaluar se vendi i tij e ka kaluar kulmin e shpërthimit të koronavirusit. Megjithatë, numri i të infektuarve është ende në rritje.
Të hënën autoritetet ruse raportuan edhe për 9 035 raste të reja me koronavirus dhe për 162 viktima. Në total, Rusia ka mbi 414 800 të infektuar - më së shumti në botë pas Shteteve të Bashkuara dhe Brazilit - dhe 4 855 viktima.
Zyrtarët thonë se numri i ulët i viktimave është për shkak të numrave të lartë të testimeve.
Kritikët, megjithatë, frikësohen se numri i vërtetë mund të jetë shumë më i lartë.



# Turqia hap dy spitale të reja për pacientët me Covid-19



Ankara, 1 qershor - Turqia ka hapur dy spitale të reja për të infektuarit me Covid-19. Spitalet janë hapur në Stamboll. "Ne parandaluam përhapjen e pandemisë edhe pa pasur nevojë për kapacitetin shtesë që krijuam me këto spitale", ka thënë presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan.
Njëri nga spitalet, pranë ish-aeroportit Ataturk, ka një kapacitet për pranimin e mbi 1 000 pacientëve dhe u ndërtua për 45 ditë.
Gjatë 24 orëve të kaluara Turqia regjistroi 839 raste me Covid-19.
Ministri i Shëndetësisë, Fahrettin Koca, ka theksuar se numri i përgjithshëm i të infektuarve ka arritur në 163 942.
Rastet e para në Turqi u paraqitën më 11 mars.
Numri i përgjithshëm i viktimave ka arritur në 4 540.
Turqia renditet në vendin e dhjetë në të gjithë botën, për numrin e rasteve me Covid-19.

## Irani, i gatshëm të dërgojë më shumë naftë në Venezuelë

Tehran, 1 qershor - Ministria e Jashtme e Iranit ka njoftuar se Teherani do të vazhdojë të eksportojë naftë në Venezuelë, nëse kjo e fundit kërkon më shumë furnizime. Edhe Irani, edhe Venezuela janë nën sanksione të ShBA-së dhe Uashingtoni ka kërkuar që të ndërpriten dërgesat. "Irani praktikon të drejtat e tregtisë së lirë me Venezuelën dhe ne jemi të gatshëm të dërgojmë anije të tjera nëse Karakasi kërkon më shumë furnizime nga Irani", tha zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme iraniane, Abbas Musavi.
Irani ka dërguar së voni pesë cisterna me naftë në Venezuelë - vendin që po përballet me mungesë për shkak të krizës ekonomike.
Shtetet e Bashkuara i kanë paralajmëruar qeveritë, portet detare dhe transportuesit se mund të përballen me ndëshkime nëse i ndihmojnë cisternat e Iranit.
Deri më tani katër cisterna kanë hyrë në ujërat e Venezuelës.
Tensionet midis Iranit dhe ShBA-së janë në rritje qysh në vitin 2018, kur presidenti amerikan Donald Trump është tërhequr nga një marrëveshje



bërthamore me Republikën Islamike dhe ka rikthyer sanksionet kundër saj.

E jashtëzakonshme

# Pas Covid-19 dhe valës së të nxehtit, India ballafaqohet me "pushtimin" e miliarda karkalecave



Numri i të infektuarve me Covid-19 në Indi është duke u rritur dita-ditës, kryeqyteti i këtij vendi është duke u ballafaquar me një valë të të nxehtit që nuk mbahet në mend, kurse 100 milionë njerëz kanë mbetur pa punë, e të njëjtën kohë vendi po lufton me një problem tjetër - "pushtimin" nga miliarda karkaleca. Shkencëtarët thonë se është "pushtimi" më i tmerrshëm në 25 vjetët e fundit dhe se bëhet fjalë për një lloj unik të karkalecave që lëvizin me shpejtësi të madhe.

FOTO E DITES



Infermierët në Kenia marrin pjesë në një program të palestrës aerobike Zumba, si një mënyrë për t'i ndihmuar ata të përballen me situatat e punës gjatë shpërthimit të koronavirusit / Reuters/

E rrallë

# Kuzhinieri gatoi një sandviç dy metra, në mënyrë që të respektohet distanca mes klientëve



Të gjithëve na mungon frekuentimi i restoranteve tona të preferuar por, pas bllokimit të Covid-19, ato nuk do të duken sikur më parë. Sipas mediave të huaja, tanimë mund të hamë jashtë, të ulemi larg të tjerëve, madje të kemi barriera midis nesh për ta frenuar përhapjen e koronavirusit. Një super kuzhinier në Angli ka dalë me një ide interesante sa i përket kësaj çështjeje. Ai gatoi një sandviç dy metra të gjatë në mënyrë që të respektohet distanca.

## BARSOLETA E DITËS



**Shëtit zezaku nëpër Prishtinë dhe duke ecur e gjen një letërnjoftim. Pa u menduar shumë, e futë në xhep. Pas pak e ndalon një polic dhe ia kërkon letërnjoftimin. Zezaku, pa u hamendur, e nxjerr letërnjoftimin e gjetur dhe ia jep.**
**- Leonardo Di Kaprio, lexon polici.**
**- Allahile, a po më tregon drejt, 'Titaniku', a është fundosur apo është kallë?, e pyet polici zezakun.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00

### Spies in Disguise 3D



I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00

### Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
**Regjia:** Jake Kasdan

Çdo natë në ora 20:00

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D



Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
**Regjia:** J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Mos u drejtoni nga impulsiviteti në trajtimin e një çështje familjare, mbase të një natyre financiare.



**DEMI**
Gjatë ditës do të merrni disa lajme interesante. Mos kërkoni të pamundurën nga njerëzit e afërt.



**BINJAKËT**
Do të jeni të gatshëm për të përfituar nga mundësitë e favorshme për të lidhur marrëveshje të mira, nëse keni një biznes.



**GAFORRJA**
Do të dëshironi që të shkoni në shtrat sa më herët për të harruar gjithçka që ndodh rreth jush dhe shumë telashe që keni mbi kokë.



**LUANI**
Të rrethuar me kaq shumë yje pozitivë dhe me energjitë pozitive, do të merrni shumë zell dhe do të filloni të punoni pa kursyer veten për të arritur sukses dhe fitime.



VIRGJËRESHA
Do të keni një ditë të mbushur me çaste shumë pozitive. Lëvizja astrale që ka filluar këto ditët e fundit do t'ju bëjë që të kini rritje të burimeve financiare.



PESHORJA
Përpiquni shumë që t'i arrini sukseset që keni dëshiruar dhe t'i inkurajoni çështjet që ju interesojnë kaq shumë.



**AKREPI**
Ju do të jeni në gjendje që të shpëtoni nga një situatë e pakëndshme apo problem dhe të realizoni atë që dëshironi.



SHIGJETARI
Për sytë e miqve ju jeni çifti perfekt, shumica ju admirojnë, por ekzistojnë disa që ju kanë zili.



BRICJAPI
Më në fund do të keni mundësi të sqaroni disa çështje profesionale që nuk i keni kushtuar shumë rëndësi më parë.



**UJORI**
Qielli ju fton në mënyrë eksplicite që ta përdorni imagjinatën dhe fantazinë në punën tuaj. Maji, muaj pasionant për ju.



PESHQIT
Dite e mrekullueshme. Ju jeni plot entuziazëm dhe më luftues se zakonisht, kështu që do të përballeni me problemet e momentit me më shumë vendosmëri.




# SALMAN RUSHDIE: SHKRUAJ PËR LEXUESIT, JO PËR KRITIKËT

S'mund t'ia lejosh vetes të mendosh për kritikën kur po shkruan librin. Është tepër e vështirë ta shkruash librin dhe në të njëjtën kohë, të rrekesh të hamendësosh si do të jetë reagimi kritik ndaj tij. Por them se i përfytyroj mjaft mirë lexuesit e mi. Ndërsa vitet mbi supe më shtohen, interesohem gjithnjë e më shumë për mënyrën se si lexojnë njerëzit, çfarë ka të ngjarë t'i largojë dhe t'i tërheqë. Jam bërë më i vetëdijshëm për lexuesin. Them se kur isha më i ri thjesht shkruaja; nëse lexuesit shfaqeshin diku, shumë mirë, nëse jo, s'prishte punë. Kam pasur një lloj qëndrimi shumë më të ashpër. Por tani jam vërtet i interesuar të lexohem, për dukurinë e leximit dhe si, nëse informacionin e jep në rendin e saktë, mund të tregosh gjëra shumë të ndërlikuara, të cilat për lexuesin bëhen të rrokshme, kanë lidhje me ta dhe u ngjallin dëshirën për t'i zbuluar. Për shembull, në rastin tim, gjithmonë kam menduar që komedia ndihmon shumë. Mendoj se nëse arrin t'i bësh njerëzit të qeshin, mund t'u thuash gati çdo gjë. Nëse s'i bën dot të qeshin, s'do të duan të të dëgjojnë për një kohë të gjatë. Kjo është e para. Por për kritikët, për një lloj reagimi kritik ndaj asaj që shkruaj, s'mendoj dot. Dua të them se në këtë




moshë kupton se ka njerëz që s'do ta pëlqejnë çfarëdo që të shkruash.

Kësisoj, e dija që mund të shkruaja librin më të mirë që mund të shkruaj dhe sërish do të kishte disa që thjesht s'do ta pëlqenin, dhe s'ka gjë për t'u çuditur këtu. Kjo është arsyeja pse në librari ka lloje të ndryshme librash, që njerëzit të zgjedhin atë që u pëlqen. Prandaj s'më shqetëson kjo. Përnjëmend s'më shqetëson reagimi i kritikës. Kur ke shkruar disa libra, e ke të qartë drejtimin nga do të shkosh. Këndvështrimi im është: tani për tani do të shkoj në këtë drejtim dhe vërtet shpresoj se dëshironi të vini me mua. Shpresoj ta shijoni udhëtimin dhe kështu me radhë, por nëse, për çfarëdo arsyeje, s'mund të më shoqëroni në këtë udhëtim, unë do të vazhdoj të ndjek rrugën time. Dhe atëherë merr me vete kë të mundesh në këtë arrati. Mendoj se, në përgjithësi, kam pasur goxha shumë shoqërues gjatë arratisjeve të mia. Mund të parashikoj se kur ndodh aksident me kritikën letrare gjatë udhëtimit, sepse e marr me mend, por në njëfarë mënyre kjo s'ka rëndësi. Dua të them, mbaj mend që në një lloj epoke të parainternetit kishte një kohë kur revista të ndryshme letrare përdoreshin për të botuar recensione në mënyrë anonime dhe më e famshmja Times Literary Supplement s'i përmendte kurrë emrat e kritikëve të saj. Ideja ishte që të krijohej përshtypja që ishte Times që po jepte mendimin e saj për veprën tënde dhe jo një individ. Dhe pastaj në kohë tjetër, them se diku në vitet 1980, kjo politikë u ndryshua duke vënë emrat e kritikëve. Menjëherë vlerësimet u bënë shumë më të matura, sepse emri i kritikut i bashkëngjitej kritikës letrare.

S'ka dyshim se mënyra si jetojmë me internetin është gjysmë imagjinare. E para, njerëzit përdorin emra të rremë gjatë gjithë kohës, përdorin vazhdimisht pseudonime dhe për këtë arsye, mund të shpikin vetveten për të qenë në internet pa i pyetur se kush janë. Mendoj se kjo mund të jetë e mirë dhe e keqe. E shoh qartë se çfarë ndodh në pjesë të botës që janë shoqëri më pak të hapura, që anonimati i lejon njerëzit të shprehen pa frikë. Dhe mendoj se ka një lloj lojcakërie në këtë. Shpik për veten një emër të çmendur dhe mbase mund të jesh një person pak më ndryshe me atë personalitet sesa të mundesh të jesh si vetvetja. Kështu, ka shumë për të thënë për këtë çështje. Dua të them se më pëlqen shumë lojcakëria dhe një lloj aspekti



çlirues i saj.
Një lloj shqetësimi që kam për disa përdorues anonimë të internetit është se kjo krijon deri diku dukurinë e karremit. Duke qenë plotësisht i sigurt pas ekranit të emrit imagjinar, ti mund të jesh shumë, shumë i pasjellshëm. Kam frikë ndonjëherë se po bëjmë të mundur të kemi një brez njerëzish shumë të vrazhdë që mund të flasin në internet në një mënyrë që kurrë s'do të flisnin nëse do të ishin në dhomë me ty. Ky është shqetësimi im. Por mendoj se, në përgjithësi, është një hapësirë e gjallë. Është një hapësirë ku njerëzve u pëlqen të jenë shpikës dhe imagjinues për veten e tyre dhe teknologjia u lejon ta bëjnë këtë.
*2019*

## Shënime për letërsinë dhe kombin

*Mëllenja po këndon Cilgëri te pyllishta*
*Pa pushim si rrjedha mbi gurët e myshkëta*
*S'është aq e moçme sa thithëlopa e Cors Fochno-s*
*Me lëkurën e ngjitur në kocka.*

1
Pak shkrimtarë i këndojnë me kaq pasion tokës së të parëve të tyre sa R. S. Thomas-i, një nacionalist uellsian i cili, me anë të poezive që sjellin në vëmendje, pohojnë, kthehen në rapsodi, krijojnë mite, kërkon të shkruajë për kombin si qenie e ashpër lirike. Megjithatë, është po ky R. S. Thomas, i cili po kështu shkruan:

*Urrejtjes i duhet një kohë e gjatë*
*për t'u rritur dhe kjo imja*
*ka nisur të rritet qysh kur linda;*
*S'ushqehet nga toka mizore, por prore*
*e kam për veten k'të urrejtje, ësht' imja*

Është befasuese të shohësh se sa hapur pranohet diçka e përafërt me urrejtjen për veten në vargjet e një bardi kombëtar. Por ndoshta vetëm kështu mund të shkruajë një shkrimtar nacionalist. Kur imagjinata merr dritë nga pasioni, atëherë ajo sheh errësirën ashtu si dhe dritën. Të ndiesh në mënyrë kaq të egër, do të thotë të ndiesh njëherazi përçmim dhe krenari, urrejtje dhe dashuri. Ky përçmim krenar, kjo dashuri urrejtëse, shpesh ngjallin ndaj shkrimtarit zemëratën e kombit. Kombi kërkon himne, flamuj. Poeti të jep paqetësi. Zhele.

2
Ekzistojnë lidhje mes zhvillimit historik të "narrativës" binjake të romanit dhe shtetit-komb. Shtjellimi i një rrëfenje në fletën e bardhë drejt synimit të fundmë ngjan me imazhin që ka për veten një komb, që përshkon historinë për të përmbushur fatin e tij të paracaktuar. Pavarësisht sa tërheqës mund të jetë një paralelizëm i tillë, unë e shoh atë me shumë rezerva. Njëmbëdhjetë vjet më parë, në kongresin e famshëm të PEN në Nju-Jork, shkrimtarët e botës diskutuan "Imagjinatën e shkrimtarit dhe imagjinatën e shtetit", një temë e cila ka shkëlqimin e temës së parapëlqyer të Norman Mejlërit, një vizion që pa dyshim ai e ka pasur kur shkruante. Është e habitshme se në sa mënyra mund të interpretohet kjo "dhe" në titullin e konferencës. Për shumë nga ne, do të thotë "kundër". Shkrimtarët afrikano-jugorë, Gordimer-Coetzee, në kohën e aparteidit u rreshtuan kundër përkufizimit zyrtar të kombit, duke e shpëtuar ndoshta kombin e vërtetë nga ata që e kishin marrë peng. Xhon Apdajk krijoi një himn lavdërues për kutitë e vogla postare të Amerikës, të cilat për të ishin emblema të përhapjes së lirë të ideve. Danilo Kiš na ka dhënë një shembull "të shakasë" që ka bërë me të shteti: një letër që ai mori në Paris, ishte nisur nga ajo që atëherë quhej Jugosllavi. Brenda zarfit të vulosur, në fletën e përparme të zarfit, ishte stampuar fjalia: "Kjo letër është e pacensuruar."




3
Kombi ose bën pjesë të tij shkrimtarët e vet më të mëdhenj (Shekspiri, Gëte, Tagore) ose kërkon t'i shkatërrojë ato (ekzili i Ovidit, ekzili i Soyinka-s). Këto fate nuk janë kaq të ndara nga njëri-tjetri. Mosnderimi i shkrimtarëve nuk është i denjë për letërsinë; shkrimtarët e mëdhenj shkaktojnë trazim në mendje dhe në zemër. Ka nga ata që besojnë se persekutimi është diçka e mirë për shkrimtarët. Kjo nuk është e vërtetë.

4
Kini parasysh shkrimtarin që e sheh veten si zëri i një kombi. Bëhet fjalë për kombin e racës, gjinisë, orientimit seksual. Kjo është rryma e re e të "të folurit në emër të…". Kini parasysh ata që flasin në emër të…" Kjo rrymë e re kërkon, lartësohet, thekson pozitiven, paraqet udhëzime turbulluese morale. Tmerrohet nga kuptimi tragjik i jetës. Ta shohësh letërsinë si pashmangshmërisht politike, do të thotë që vlerat politike të zëvendësojnë vlerat letrare. Kjo e vret mendimin. Kini kujdes!



5
Po ju them që pasaporta ime është jeshile. Amerika po vë shpatullat e mia të hajthme në rrotën e historisë. Për të farkëtuar çelikun e shpirtit tim, ndërgjegjen e pakrijuar të racës sime. Shqipëria e Kadaresë, Bosnja e Ivo Andriçit, Nigeria e Achebe-s, Kolumbia e García Markezit, Brazili i Jorge Amados tregon që shkrimtarët e kanë të pamundur të mohojnë ngadhënjimin e kombit, shkulmat e tij në gjakun tonë. Shkrimësia si harta e një vendi: si hartografi e imagjinatës. (Ose siç mund ta shkruajë teorika moderne kritike sot, "Imagi/ Nation". Në shkrimet më të mira, sidoqoftë, harta e një vendi është harta e botës.

6
Historia është bërë e diskutueshme. Si pasojë e Perandorisë, në epokën e superfuqisë, pas "gjurmëve" të thjeshtëzimeve që na japin satelitët, zor të biem dakord për thelbin e debatit, e jo më për kuptimin e tij. Letërsia bëhet pjesë e këtij qarku. Historianët, zotët e medias, politikanët, nuk e vrasin mendjen për ndërhyrjen e bezdisshme të letërsisë, por ky i paftuar është kokëfortë. Në këtë atmosferë të paqartë, mbi këtë tokë të nëpërkëmbur, në këto ujëra të pista me baltë, letërsia ka lëndën e saj të parë.

7
Nacionalizmi po kështu mund t'i korruptojë shkrimtarët. Të tilla ishin ndërhyrjet helamtisëse të Vide Limonovit për luftën në ish-Jugosllavi. Në kohën e nacionalizmave në kuptimin më të ngushtë të fjalës, në kohën e nacionalizmit si thirrje për luftë e fisit, shkrimtarët mund ta gjejnë veten duke shqiptuar këto klithma lufte të fiseve të tyre. Sistemet e mbyllura kanë tërhequr gjithmonë vëmendjen e shkrimtarëve. Kjo është arsyeja pse është shkruar kaq shumë për burgjet, forcat policore, spitalet, shkollat. A është kombi një sistem i mbyllur? Në këtë moment të ndërkombëtarizimit të gjithçkaje, a ekziston ndonjë sistem që mund të mbetet i mbyllur? Nacionalizmi është "revolta ndaj historisë", e cila kërkon të mbyllë atë që nuk mund të mbahet më e mbyllur. Të vendosë kufij tek ajo që duhet të jetë pa kufij. Letërsia e mirë shkruan për një komb pa kufij. Shkrimtarët që kanë shkruar për ekzistencën e kufijve janë shndërruar në roja kufiri.

8
Nëse shkrimësia kthehet në mënyrë të përsëritur te kombi, ajo po ashtu në mënyrë të përsëritur largohet prej tij. Qëllimisht çrrënjosja intelektuale (Naipaul) e sheh botën si një inteligjencë të lirë, duke shkuar atje ku është veprimi dhe duke ofruar raporte. Intelektuali, qëllimisht i paatdhe (V.S Naipaul), e sheh botën ashtu si mund ta shohë një njeri me inteligjencë të lirë, duke dëshmuar ngjarjet ashtu si ndodhin. Intelektuali i paatdhe, kundër vullnetit të tij (një kategori shkrimtarësh në të cilën bëjnë pjesë shumë shkrimtarë të shkëlqyer arabë), refuzon mbylljen në një rreth refuzues për të. Një paatdhesi e tillë përbën një humbje dhe mall të madh. Por edhe fitore. Kombi pa kufij nuk është fantazi.

9
Një pjesë e madhe e letërsisë së epërme nuk ka nevojë për përmasën e të qenit publik. Agonia e saj vjen nga brenda. Sfera publike s'është asgjë, ashtu siç nuk ishte për shkrimtaren amerikane Elizabeth Bishop. Burgu-liria-lënda e shkrimësisë është diku tjetër.

*Nina nana.*
*Kombet zemërohen,*
*Shuhen si të mos ishin kurrë.*
*Hija e koçekut të misrit një kafaz i madh*
*mbi mur.*/exlibris.al




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Sejdiu: Ndaj Prishtinës duam rezultat pozitiv

Futbolli në Kosovë rikthehet me ndeshjen gjysmëfinale të Kupës në mes të Prishtinës dhe Drenicës. Të dyja klubet kanë synime të mëdha në këtë ndeshje për faktin se duan të kualifikohen në finale të kësaj gare. Trajneri Gani Sejdiu me Drenicën për ndeshjen në kryeqytet synon të paktën një barazim në mënyrë që në ndeshjen kthyese në Skenderaj të ketë më të lehtë kualifikimin në finale



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Sot (e martë), pas një pauze gati tremujore për shkak të koronavirusit, do të nisin ndeshjet në futbollin e Kosovës. Ndeshja e parë është ajo e gjysmëfinales së parë të Digitalb Kupës së Kosovës në mes të Prishtinës dhe Drenicës, e cila zhvillohet nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.
Trajneri i klubit kuqezi nga Drenica, Gani Sejdiu, të hënën për "Epokën e re" ka thënë se ndeshja që zhvillohet në kryeqytet është e vështirë për klubin nga Skenderaj, por synim është një rezultat pozitiv në mënyrë që në ndeshjen e kthimit të arrihet fitorja dhe kualifikimi në finale të Kupës. "Lajm i mirë është se po kthehemi për t'i zhvilluar ndeshjet, por do të jetë një problem i madh për faktin se po kthehemi pas një pauze të gjatë. Gjendja fizike e futbollistëve është ajo që më shqetëson më së shumti. Pa dyshim se nuk duhet të harrojmë se kundërshtar kemi një ekip të fortë si është Prishtina. Kundërshtari ka filluar më herët përgatitjet, por ne nuk jemi të dorëzuar. Motivi në klub është i madh që të nxjerrim rezultat pozitiv dhe në ndeshjen e kthimit të dalim fitues dhe ta sigurojmë finalen. Një problem tjetër për klubin tonë është mungesa e sulmuesit kyç Alban Shillova, i cili nuk ka të drejtë loje kundër Prishtinës", ka thënë Sejdiu për "Epokën e re".
Për ndeshjen gjysmëfinale të Kupës ka folur edhe kapiteni i Prishtinës, Armend Thaqi. Mbrojtësi i djathtë i skuadrës kryeqytetas ka thënë se finalja e Kupës është synim i Prishtinës, prandaj në këtë ndeshje synohet rezultat sa më pozitiv për t'ia arritur këtij qëllimi. "Po fillojmë sërish, pas një pauze jo të dëshiruar, e pas përballjes me pandeminë globale, duke shpresuar se tani më e kemi tejkaluar. I kthehemi ndeshjes së parë kundër një kundërshtari të vështirë siç është Drenica. Tradicionalisht vuajmë kundër Drenicës sepse ka ekip të mirë dhe lojë të rrjedhshme tani e disa vite rresht. Ne hyjmë në ndeshje për rezultat sa më pozitiv për ndeshjen e kthimit. Të gjithë e dinë synimin tonë, që ta arrijmë finalen e t'u afroheshim shumë garave ndërkombëtare", ka thënë Thaqi.
Gjysmëfinalja e parë e ndeshjes tjetër në mes të Ballkanit dhe Feronikelit zhvillohet të mërkurën nga ora 16:00 në Suharekë. Siç dihet, skuadra fituese e Kupës së Kosovës e prezanton Kosovën në garën e Ligës së Evropës, kurse fituese në fuqi i kësaj gare është skuadra e Feronikelit nga Drenasi.

**DIGITALB KUPA**

**Të martën takohen:**
18:00 Prishtina - Drenica

**Të mërkurën takohen:**
16:00 Ballkani - Feronikeli

## SHKURT

### Drita 'blindon' edhe trajnerin Nuhiu

Skuadra e Dritës nga Gjilani, pasi arriti marrëveshje të re me kapitenin Ardian Limani, të njëjtën gjë e bëri edhe me trajnerin Ardian Nuhiu. Sipas njoftimit të klubit, marrëveshja me trajnerin shkupjan është arritur edhe për dy vjetët e ardhshëm. "Pas një takimi të shkurtër është arritur marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimit me trajnerin tonë Ardian Nuhiu edhe për dy vjetët e ardhshëm. Drejtori i përgjithshëm Feti Murseli është shprehur tejet i kënaqur me punën profesionale dhe përkushtimin e trajnerit shkupjan Ardian Nuhiu dhe për të cilin i është besuar klubi edhe për dy vjetët e ardhshëm. Klubi ynë i dëshiron suksese në qëllimet tona të përbashkëta trajnerit", thuhet në njoftimin e Dritës.

### Batatina: Për Veliun dhe Salihun kemi oferta nga jashtë

Pas Mirlind Dakut dhe Festim Alidemës rrugën drejt ligave evropiane mund ta marrin edhe dy yjet e klubit, Valmir Veliu dhe Hajdin Salihu. Lajmin e ka konfirmuar trajneri Tahir Batatina. "Këta janë yjet e skuadrës së Llapit, të cilët shumë shpejt pritet ta shijojnë arenën evropiane dhe transferimin në klube evropiane. Ofertat konkrete veç se kanë mbërritur për dy futbollistët, Valmir Veliun dhe Hajdin Salihun, kurse nën vëzhgimin e klubeve evropiane do të jenë edhe Kastriot Selmani e Alban Shabani, të cilët do të përcillen në ndeshjet në vijim të kampionatit. Ajo çfarë kam deklaruar shpeshherë po përmbushet me sukses. Talentët e KF Llapit dhe të tjerave qytete e dinë destinacionin për në Evropë, KF Llapi ua jep mundësinë dhe realizimin e ëndrrës së futbollistëve - Evropën", ka thënë Batatina.

### 'Final Four' i Ligës Ballkanike organizohet në Pejë

BIBL po i kthehet botës së basketbollit, pas ndërprerjeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19. BIBL ka dërguar njoftimin me planin për sezonin e ardhshëm. Shpresat janë që sezoni të nisë në tetor të vitit 2020 dhe do të nisë me rregullat e dhëna nga FIBA më 26/05/2020. "Ne do t'i ndjekim instruksionet dhe do të veprojmë në akordancë me federatat nacionale dhe klubet", thuhet në njoftimin e BIBL.
Para fillimit të sezonit 2020/21, në shtator do të luhet Final Four, për ta mbyllur sezonin 2019/20. Eventi pritet të mbahet në Pejë, me KB Peja si organizatore. Katër skuadrat që paraqiten do të jenë Akademik Bultex, KB Peja, KK Ibar dhe Vllaznia. Në këtë mënyrë, të katër skuadrat do të kenë mundësi të barabarta. Kurse për sezonin tjetër, të gjitha vendet do të kenë nga dy skuadra – Shqipëria, Kosova, Bullgaria, Mali i Zi, Maqedonia Veriore dhe vendet e tjera ballkanike.

## Aliti: Shqiptarët mezi e presin ndeshjen me Maqedoninë



PRISHTINË, 1 QERSHOR - Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Fidan Aliti, ka thënë se të gjithë duhet ta pranojnë situatën aktuale që ka shkaktuar Covid-19 ani pse të gjithë shqiptarët kanë qenë në pritje të ndeshjes ndaj Maqedonisë së Veriut. “Duhet ta pranojmë situatën ashtu siç është. Të gjithë kemi qenë të përqendruar nga janari për këtë ndeshje. Të gjithë shqiptarët e kanë pritur këtë ndeshje”, ka thënë Aliti, i cili bëri me dije se po i mungojnë emocionet që sjellin ndeshjet e Kosovës kur zhvillohen në stadiumin “Fadil Vokrri”. “Gjithmonë në ‘Fadil Vokrri’ është një atmosferë fantastike dhe më mungojnë ato emocione. Këto gjëra e bëjnë një futbollist krenar”, ka shtuar Aliti.

# Trajneri që kurrë nuk u pajtua me humbje

“Unë kurrë nuk e kam pranuar humbjen. Në një sezon që i kisha dy humbje, menjëherë kam dhënë dorëheqje”, ka thënë trajneri që ka bërë histori në futbollin e Kosovës me ekipin “Arbëria” të Dobrajës së Madhe të Komunës së Lipjanit



EPOKA E RE **Ismail REXHEPI**

LIPJAN, 1 QERSHOR - Suksesit të “Arbërisë” iu gëzuan të gjithë. Një ekip i një fshati të bëjë gara në elitën e futbollit të shtetit ishte një mrekulli. Pra, ky ekip i këtij fshati u dërgoi mesazh të gjitha ekipeve të futbollit në Kosovë se në Komunën e Lipjanit se është një ekip që ka dëshmuar me punë deri te ky sukses. Iu gëzuan të gjithë këtij suksesi të “Arbërisë”. Për këtë sukses s’do mend se meritat i takojnë të gjithë lojtarëve, donatorëve, adhuruesve, fshatarëve por, mbi të gjitha, edhe drejtuesve të tij, në krye me kryetrajnerin Nuhi Bahtiri. Në këtë intervistë, trajneri, i cili ka qenë futbollist i dalluar kudo që ka luajtur, ka treguar modesti gjatë bisedës.

*Na flisni pak për gjenezën e ekipit tuaj?*

**Nuhi Bahtiri:** Një sezon kam luajtur në KF “Arbëria” në vitin 1977-’78. Pra, isha futbollist që nga dita e parë kur u themelua klubi. Bazuar në këto të dhëna, del se jam veteran i ekipit që tash është në elitën e futbollit të vendit.

*Po për punën tuaj, çfarë na tregoni?*

